

VENDIM
Nr. 522, datë 25.9.2025

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHETETËRORE TË
MINISTRIT TË SHETIT PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE
ANTI-KORRUPSIONIN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin është përgjegjës për administratën publike dhe për luftën kundër korrupsionit.

3. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin ushtron veprimtarinë në këto fusha përgjegjësie shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës:

a) Drejtimin dhe bashkërendimin e punës për propozimin e akteve dhe politikave për:

i. zbatimin e reformës tërësore në administratën publike, përfshirë këtu menaxhimin e burimeve njerëzore në administratën publike dhe sistemin e pagave, zhvillimin dhe koordinimin e politikave dhe promovimin e inovacionit në administratën publike;

ii. çdo ndërhyrje tjetër në zbatim të reformës në administratën publike;

b) Drejtimin dhe bashkërendimin e punës për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

4. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin ka rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, si dhe ushtron çdo përgjegjësi tjetër shtetërore që i ngarkohet me ligj, me akte të Këshillit të Ministrave dhe nga Kryeministri.

5. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin është përgjegjës për përmbushjen e parimeve të qeverisjes së mirë dhe bashkëdrejtues i Komitetit Shumëpalësh të Partneritetit për Qeverisje të Hapur.

6. Vendimi nr. 29, datë 17.1.2024, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin”, shfuqizohet.

7. Ngarkohet ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama